

Konkluzionet e përbashkëta mbi kthimin nga Shtërpsa në Ferizaj

11 maj 2007

Sot Ministri për Komunitete dhe Kthim u takua me nënkryetarin e Ferizajit, zyrtarët për kthim nga Shtërpsa dhe Ferizaji, përfaqësues të të zhvendosurve intern, si dhe ata të AKP-së, UNDP-së dhe UNCHR-it për të diskutuar situatën e kthimit në Ferizaj. Të gjithë shprehën keqardhje që kryetari i komunës së Ferizajit nuk kishte mundësi të merr pjesë në takim. Në vazhdim janë përfundimet nga takimi:

1. Të gjithë e mirëpresin përkushtimin e Ministrit për Komunitete dhe Kthim për të marrë pjesë dhe diskutuar mbi çështjet e kthimit me theks të veçantë në kthimin e të të zhvendosurve prej Shtërpsës në Ferizaj. Të gjithë e mirëpresin kontributin e tij në diskutim dhe mbështetjen e procesit të kthimit.
2. Ministria për Komunitete dhe Kthim është pajtuar të mbështes përfaqësuesit e të të zhvendosurve. Ministri do të emërojë një zyrtar për të punuar me të zhvendosurit në çështjet e tyre specifike. Ky zyrtar do të mbajë takimet e rregullta me përfaqësuesit e të zhvendosurve.
3. Përfaqësuesit e të zhvendosurve kanë kërkuar nga komuna e Ferizajit të hetojë çështjen e shfrytëzimit ilegal të pronës private të të zhvendosurve për qëllime komerciale. Nënkryetari është pajtuar që qeveria komunale t'i bëjë hetimet nëse grupi punues përgatit dokumentacionin përkatës. Nënkryetari poashtu është pajtuar të përkujdeset që në takim të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e drejtoratit për urbanizëm për të diskutuar çështjen kur i njëjti të organizohet nga grupi punues.
4. Grupi punues komunal për kthim i kanë kërkuar nënkryetarit dhe zyrtarit për kthim të Ferizajit që të përpilojnë koncept dokumentin për kthimin në Shtërpsë me theks të veçantë në kthimin në qendrën urbane të komunës së Ferizajit.
5. Duke marrë parasysh se UNCHR-i dhe UNDP-ja punojnë me të zhvendosurit intern nga Shtërpsa që kërkojnë të kthehen në Ferizaj, është dakorduar që të dy organizatat të takohen me zyrtarët për kthim dhe me Partners Kosova që përfaqësojnë CSSP-në para takimit të grupit punues komunal për kthim për t'i koordinuar aktivitetet, informatat dhe strategjinë.
6. Të gjithë e falënderojnë AKP-në për pjesëmarrje në takim dhe për ofrimin e pasqyrës së përgjithshme të mandatit të AKP-së. Është me rëndësi që grupi punues të kontrollojë statusin e pronës së çdo të zhvendosuri intern për të parë nëse AKP-ja ende ka obligime ndaj kësaj prone. Statusi i çdo proneje duhet t'i shtohet listës së përbashkët.

7. CSSP do të kryejë dy aktivitete për të mbështetur procesin e kthimit. Ashtu siç është kërkuar nga përfaqësuesit e të zhvendosurve intern, një grup i vogël i të të zhvendosurve do të ketë mundësinë të bisedojë me fqinjët e tyre në Ferizaj për të diskutuar mbi situatën e kthimit. Për më tepër, përfaqësuesit e të të zhvendosurve do të kenë mundësinë të bisedojnë edhe me të kthyerit dhe udhëheqës komunal të Klinës mbi situatën e kthimit urban. Është sugjeruar që përfaqësuesit e Ferizajit poashtu të marrin pjesë në këtë aktivitet. Të dyja aktivitetet do të mundësohen nga Partners Kosova. Të dyja aktivitetet do të mbahen pa praninë e mediave dhe pa mbulesë të mediave. Aktivitetet do të koordinohen me UNCHR-in dhe UNDP-në.

Konkluzionet e përbashkëta janë aprovuar me aklamacion verbal në takim me kusht që ato të shpërndahen pas përkthimit. Të gjithë të pranishmit mund të komentojnë deri më 30 maj 2007 ku pas kësaj konkluzionët konsiderohen të miratuara.